



Titulli i projektit

Dixhitalizimi i shërbimeve të NJV në zonën funksionale.

Tipi i projektit

Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

NJV e zonës funksionale

Buxheti i paravlerësuar

100,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Bazuar në ligjin 8652 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendor në Shqipëri”, NJQV kryejnë disa funksione kryesore në zonën tyre, që lidhen me: i) infrastrukturën dhe shërbimet publike; ii) shërbimet me karakter social, sportiv dhe kulturor; iii) zhvillimet me karakter ekonomik vendor dhe iv) mbrojtja e sigurisë civile.

Me mbulimin me shërbime të të gjithë territorit të zonës funksionale, përgjegjësia e njësive vendore do të rritet për të siguruar shërbime konkrete dhe në kohë reale për qytetarët e njësive së madhe. Aktualisht ekziston zyra e informimit të qytetarëve, por aksesit i informacionit do bëhet shumë më i vështirë për banorët e zonave të largëta të njësive vendore aktuale. Dixhitalizimi i informacionit aktualisht mungon krejtësisht në Bashkinë Peshkopi dhe njësitë e tjera vendore. Ky projekt synon këtë lloj ndërhyrjeje, për ta sjellë njësinitë vendore më afër qytetarëve dhe për t'i dhënë mundësinë stafit të njësive vendore të marrë vendime korrekte dhe efikase.

Duke parë kompleksitetin e detyrave, njësive së qeverisjes vendore i nevojitet një sistem që të unifikojë ofrimin e shërbimeve në kohë reale.

Projekti synon zhvillimin / zbatimin e një sistemi GDI Localis, që ofron zgjidhje GIS të bazuara në WEB, të konfigurueshme, të përshtatura për Cloud, të zhvilluara posaçërisht për përmirësimin dhe mbështetjen e proceseve dhe operacioneve të E-Government. Ky sistem ndihmon në kapërcimin e shumë vështirësive në veprimtarinë e qeverisjes vendore, duke mbajtur kostot e zbatimit në nivele optimale. Zgjidhjet GDI LOCALIS mbulojnë një gamë të gjerë të veprimtarive Qeveri-Qeveri dhe Qeveri-Qytetar, duke përfshirë menaxhimin e lejeve, planifikimin urban, menaxhimin e hapësirave të gjelbra, ndriçimin publik, shërbimet publike, forumin për pjesëmarrjen e qytetarëve, menaxhimin e rrugëve dhe shumë të tjera.

Objektivat e këtij projekti janë:

- Të përmirësohet shpejtësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga NJV e zonës funksionale për qytetarët, duke rritur kënaqësinë e tyre për shërbimet.
- Të rritet transparencja e aktiviteteve të administratës së NJV, duke zvogëluar pakënaqësitë dhe numrin e ankesave të publikut, si dhe duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë.
- Përmirësimi i kushteve të funksionimit të punonjësve të administratës së NJV, duke u krijuar mundësinë për të punuar më shpejt, lehtë, me më shumë efikasitet, me organizim më të mirë dhe duke nxitur në këtë mënyrë motivimin.



Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Ngritja dhe vënia në funksionim i sistemit "on line" do sigurojë shërbime cilësore dhe në kohë reale për të gjithë qytetarët e zonës funksionale. Përfitues do të jenë 82,668 banorët e zonës funksionale. Projekti do të zbatohet nga NJV e madhe, dhe përfitues janë të 15 NJV ekzistuese. Instalimi dhe zbatimi i këtij sistemi do të ofrojë:

- Përsheptimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Shërbim publik më kompetent për publikun;
- Lehtësi në zbulimin e fitimeve dhe të ardhurave;
- Vendosjen e një ndërveprimi të hapur dhe transparent me qytetarët;
- Rritjen e efikasitetit në funksionimin e infrastrukturës publike të qeverisjes vendore;
- Ndjekjen e shpenzimeve në mënyrë transparente dhe planifikimin e mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra dhe rrugëve.
- Përsheptimin e zbulimit të defekteve ose keqfunksionimeve në infrastrukturë.

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet e projektit synojnë në:

- Identifikimin e nevojave / tipareve që do të përcaktohen në sistemin online;
- Zbatimin e programit;
- Trajnimin e personelit të administratës së NJV-së;
- Përditësimin me informacionet përkatëse dhe bërjen funksionale të sistemit, duke e bërë pjesë të praktikës së funksionimit për NJV.

Maturimi i projektit

Projekti është në fazën e një ideje. Mund të aplikohet brenda vitit me kohëzgjatje 3 muaj për ngritjen dhe vënien në funksionim.

Ky sistem është aplikuar në shumë qytete të tjera jashtë Shqipërisë.

Gdi Localis është produkt i ESRIT dhe mund të përshtatet sipas nevojave specifike të NJV, bazuar në veçoritë dhe kërkesat specifike të saj

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Ky është një projekt i shpejtë. Projekti do të zbatohet nga NJV e zonës funksionale. Njësia vendore mund ta blejë me burimet e veta sistemin.

Donator i mundshëm është BE.

Kostot e projektit

- | | |
|-----------------------------------------------------------|---------------|
| • Blerja dhe vënia në funksionim e sistemit | (30,000 Euro) |
| • Krijimi i tipareve të reja sipas karakteristikës së NJV | (20,000 Euro) |
| • Leje përdorimi | (20,000 Euro) |
| • Blerje kompjuterash | (10,000 Euro) |
| • Trajnime | (10,000 Euro) |
| • Mirëmbajtje | (10,000 Euro) |